LIGJ
Nr. 16/2016

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES PËR THEMELIMIN E QENDRËS SË KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT TË BALLKANIT PERËNDIMOR (WISE)

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja për themelimin e Qendrës së Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit të Ballkanit Perëndimor (WISE).

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 10.3.2016

Shpallur me dekretin nr. 9472, datë 24.3.2016, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

MARRËVESHJE
MBI THEMELIMIN E QENDRËS SË KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT TË BALLKANIT PERËNDIMOR– WISE

Preambulë

Republika e Shqipërisë, Bosnja dhe Hercegovina, Republika e Kroacisë, Kosova, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Mali i Zi dhe Republika e Serbisë janë palë në këtë Marrëveshje (më poshtë të referuara si "Palët"),

duke mirëpritur zhvillimin kryesor dhe përparimin e arritur në rajonin e Evropës Juglindore në procesin e integrimit të Bashkimit Evropian (BE) gjatë dekadës së fundit;

duke theksuar se bashkëpunimi rajonal në kërkim dhe zhvillim është një mjet i vlefshëm bazë i sfidave të përbashkëta dhe një mjet për nxitjen e zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm dhe kohezionit social, si dhe një mjet mbështetës për integrimin evropian;

duke ritheksuar angazhimin tonë në iniciativat vazhduese të BE-së, evropiane dhe ndër-kombëtare sipas Deklaratës mbi Strategjinë Rajonale për Kërkim dhe Zhvillim të Ballkanit Perëndimor për Inovacion, të nënshkruar në datën 25 tetor 2013, në Zagreb, në veçanti, në kontekstin e dimensionit për Kërkim Shkencor dhe Inovacion të Strategjisë së SEE 2020;

duke pranuar se Strategjia Rajonale e Ballkanit Perëndimor për Kërkim Shkencor dhe Zhvillim për Inovacion është një platformë e rëndësishme për reformat mbështetëse vazhduese për kërkim shkencor dhe inovacion nëpërmjet bashkëpunimit rajonal;

duke pranuar se mbështetja politike themelore, teknike dhe financiare për përgatitjen e Strategjisë Rajonale të Ballkanit Perëndimor për Kërkim Shkencor dhe Zhvillim për Inovacion nga Banka Botërore, Komisioni Evropian dhe Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal;

duke marrë parasysh se krijimi i asistencës teknike rajonale në formën e Qendrës së Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (WISE) të Ballkanit Perëndimor parashikohet brenda Strategjisë Rajonale

të Ballkanit Perëndimor për Kërkim Shkencor dhe Zhvillim për Inovacion,
kemi rënë dakord si më poshtë:

Krijimi, misioni dhe aktivitetet

Krijimi
Neni 1

1. Me anën e kësaj Marrëveshjeje, Palët themelojnë Qendrën e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit të Ballkanit Perëndimor (që këtu e në vijim referuar si "WISE").

2. WISE-ja është një organizatë ndër-kombëtare, e pavarur, jopërfituese, e qëndrueshme në pronësi të palëve nënshkruese të kësaj Marrëveshje.

Misioni dhe qëllimi i punës
Neni 2

1. Misioni i WISE-së është të bëhet një partner i njohur dhe tërheqës në rajonin e Ballkanit Perëndimor. WISE-ja angazhohet të fuqizojë sistemet e teknologjisë dhe inovacionit të kërkimit shkencor rajonal, duke siguruar mbështetje, këshillim, informacion dhe rekomandime për shtetet, institucionet publike dhe private, organizatat joqeveritare dhe të gjithë aksionarët e tjerë të rëndësishëm, me synim fuqizimin e bashkëpunimit, në nivel rajonal, të BE-së dhe ndërkombëtar, dhe të përmirësojë klimën e kërkimit shkencor dhe inovacionit të Ballkanit Perëndimor. Në veçanti, WISE-ja do të:

a) mbrojë dhe këshillojë mbi zbatimin e reformave gjatë ofrimit si platformë për shkëmbimin e politikës së vazhduar, dialogut të politikës publike, ndërtimit të kapacitetit dhe mbrojtjes së politikës në politikën për kërkim shkencor dhe inovacion;

b) menaxhojë zbatimin e programeve strategjike me rëndësi rajonale në bashkëpunim me partnerët kombëtarë dhe të mbështesë strategjitë kombëtare me rëndësi të madhe në rezultatet dhe në vlerësimin rigoroz;

c) ofrojë platformë të qëndrueshme, afatgjatë për vendet në rajon për të ndjekur interesin e tyre të përbashkët në fushën e kërkimit dhe inovacionit dhe përmes së cilës ata mund të përparojnë në mënyrë të vazhdueshme me axhendën e politikës së tyre;

d) ofrojë shërbimet e analizës dhe ato të këshillimit që konsistojnë në raportet mbi teknologjinë dhe tendencat e politikës, praktikat e mira ndërkombëtare dhe të ngjashme, në përputhje me procesin e reformës;

e) drejtojë monitorimin dhe vlerësimin (M & V) e reformave të politikës, përparimin dhe ndikimin e saj;

f) kontribuojë në qëndrueshmërinë e progra-meve dhe politikave bashkëpunuese që promovojnë kërkimin shkencor të pavarur politikisht dhe ekonomi të qëndrueshme, duke shmangur dyfishimin e përpjekjeve të panevojshme;

g) promovojë ndërtimin e kapaciteteve për kërkimin shkencor kombëtar dhe rajonal dhe institucione inovacioni, duke përfshirë trajnimin dhe lloje të tjera shërbimesh arsimore;

h) koordinojë takime rajonale periodike dhe të mbrojë ngritjen e praktikave të mira dhe udhëzimeve të politikës;

i) grumbullojë dhe të analizojë të dhëna të rëndësishme për dialogun e politikës dhe të këshillojë shtetin mbi metodologjinë e grumbullimit të të dhënave mbi sistemin e saj të Kërkimit Shkencor dhe Zhvillimit dhe Inovacionit në përputhje me metodologjinë EUROSTAT.

2. WISE-ja do të punojë kryesisht për nxitjen e bashkëpunimit të kërkuesve shkencorë brenda dhe jashtë rajonit të Ballkanit Perëndimor, me theks të veçantë në diasporën shkencore, me qëllim që të lehtësojë përdorimin e përbashkët të shërbimeve të zgjeruara të kërkimit shkencor dhe të promovojë

[1] Ky përcaktim nuk cenon qëndrimet mbi statusin dhe është në përputhje me rezolutën 1244/1999 dhe Opinionin e GJND-së mbi Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.

qendrat shkencore të ekselencës. Përveç kësaj, WISE-ja do të promovojë lëvizshmërinë e kërkuesve të rinj dhe kandidatët për doktoraturë brenda rajonit të Ballkanit Perëndimor dhe ndërmjet rajonit dhe vendeve të tjera. WISE-ja do të punojë aktivisht për forcimin e bashkëpunimit dhe bashkërendimin ndërmjet organizatave kërkimore për më shumë investim strategjik në infrastrukturën e kërkimit shkencor, si dhe në thellimin dhe nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet organizatave kërkimore dhe industrisë.

Organizimi dhe struktura e WISE-së

Anëtarët
Neni 3

Palët e kësaj Marrëveshjeje janë anëtare të WISE-së (më poshtë të referuar si "Anëtarët").

Anëtari i asociuar
Neni 4

1. Bordi Mbikëqyrës do të vendosë mbi statusin e Anëtarit të Asociuar me një kërkesë me shkrim nga shteti apo organizata që shpreh gatishmërinë e saj për të bashkëpunuar, është dakord me objektivin dhe detyrat e WISE-së, siç parashtrohen në këtë Marrëveshje, dhe përmbush kriteret dhe jep kontribut financiar në buxhetin e WISE-së të vendosur nga Bordi Mbikëqyrës.
2. Bordi Mbikëqyrës do të vendosë për rolin, të drejtat dhe detyrimet e Anëtarit të Asociuar.

Bordi Mbikëqyrës
Neni 5

1. Bordi Mbikëqyrës (më poshtë i referuar si "Bordi") është vendimi i vetëm strategjik që përbën organin e WISE-së.

2. Bordi do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen dhe drejtimin e veprimeve të WISE-së.

Anëtarët e Bordit
Neni 6

1. Bordi i WISE-së përbëhet nga një përfaqësues dhe zëvendësuesi i tij apo i saj i caktuar nga secili anëtar.
2. Anëtarët e Bordit do të jenë zyrtarë qeveritarë të nivelit të lartë me autoritet për të vepruar në emër të anëtarëve mundësisht në nivelin e zëvendësit apo asistentit të ministrit. Kur një anëtar i Bordit nuk mund të marrë pjesë në një takim, ai apo ajo do të zëvendësohet nga zëvendësi i tij apo i saj.
3. Çdo anëtar do të ketë një votë në Bord.
4. Bordi do të ketë një kryetar dhe një bashkëkryetar. Mandati i kryetarit dhe i bashkëkryetarit do të jetë 2 vjet, i cili mund të zgjatet nga Bordi për 2 vjet të tjera.
5. Bordi vendos mbi vazhdimin e kryesimit.
6. Bordi do të caktojë një bashkëkryetar. Kryetari apo bashkëkryetari nuk do të jenë përfaqësues nga anëtarë të njëjtë.

Procedurat
Neni 7

1. Bordi mblidhet të paktën dy herë në vit.
2. Takimet shtesë mund të mblidhen kur kryetari ta çmojë të nevojshme ose me kërkesën e të paktën një të tretës të anëtarëve të Bordit.
3. Bordi duhet të ketë të paktën dy të tretat e shumicës së numrit të përgjithshëm të anëtarëve që pranojnë rregulloret e procedurës, rregullat financiare dhe rregulloret, programin vjetor të punës, planin financiar, buxhetin vjetor dhe raportin vjetor.

4. Bordi, në takimin e tij të parë të mbledhur që do të mbahet nga fundi i muajit pas muajit në të cilin kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi sipas nenit 22 të kësaj Marrëveshje, do të pranojë të gjitha dokumentet dhe procedurat e nevojshme për funksionimin e rregullt të WISE-së, duke përfshirë rregullat e procedurës dhe rregullat financiare dhe rregulloret.

5. Pas propozimit të Kryesisë së Bordit dhe pëlqimit të anëtarëve të Bordit, takimi i Bordit do të konsiderohet i hapur për të gjitha shtetet, organizatat dhe partnerët në cilësinë e të ftuarve.

Detyrat e Bordit

Neni 8

Bordi vendos, për:

a) rregullat e procedurave;

b) rregullat financiare dhe rregulloret;

c) programin vjetor të punës;

d) planin financiar;

e) buxhetin vjetor;

f) raportin vjetor;

g) emërimin e kryetarit dhe bashkëkryetarit;

h) konfirmimin e përzgjedhjes së drejtorit;

i) negocimin dhe nënshkrimin e memora-ndumit të kuptimit apo të dokumenteve politike me palët e treta dhe autoritetet;

j) vijueshmërinë e kryesimit;

k) caktimin e komiteteve të ndryshme dhe nënkomiteteve mbi çështje specifike;

l) të gjitha çështjet e tjera të rëndësishme.

Sekretariati

Neni 9

WISE-ja do të ketë Sekretariatin që është organi ekzekutiv i WISE-së, i drejtuar nga drejtori (më poshtë i referuar si "Sekretariati").

Drejtori

Neni 10

1. Drejtori do të jetë drejtues i Sekretariatit dhe përfaqësuesi ligjor i WISE-së.

2. Komiteti Përzgjedhës, i caktuar nga Bordi, do të përzgjedhë kandidatin më të mirë për drejtor për një periudhë prej tre vjetësh, mundësisht të shtrirë për tre vjet të tjera, por jo më vonë.

3. Bordi do të konfirmojë përzgjedhjen e drejtorit.

4. Drejtori do të jetë përgjegjës për Bordin. Drejtori raporton dhe jep llogari për Bordin në lidhje me përmbushjen e detyrave të tij apo të saj.

5. Drejtori është përgjegjës për organizimin e punës dhe funksionimin e WISE-së.

Personeli dhe rekrutimi

Neni 11

1. Personeli i WISE-së përfshin punonjësit: drejtorin si kreu i Sekretariatit dhe dy drejtues të Departamenteve; dhe personel tjetër: personelin e ekspertëve, administrativ dhe teknik.

2. I gjithë personeli i WISE-së duhet të ketë arsimimin e përshtatshëm dhe formimin profesional për të plotësuar nevojat e përshkrimit të punës së tyre.

3. Drejtori, drejtuesit e departamenteve dhe personeli i ekspertëve do të përzgjidhet nëpërmjet procesit të përzgjedhjes ndërkombëtarisht konkurruese.

4. Mbi një bazë përjashtimore, WISE-ja mund të përdorë nënkontraktimin si një prej metodave për rekrutimin e personelit të ekspertëve.

5. Bazuar në nevojat, Bordi do të marrë një vendim mbi kuotën, si dhe periudhën për nënkontraktimin e personelit.

6. Anëtarët do të jenë të detyruar të financojnë për të gjitha shpenzimet e punësimit për personelin sekondar.

7. Personeli administrativ dhe teknik do të rekrutohet brenda vendit për të kryer punë administrative dhe teknike.

Personeli i rekrutuar brenda vendit

Neni 12

1. Personeli i rekrutuar brenda vendit do të punësohet në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm të Vendit Pritës.

2. Personeli i rekrutuar brenda vendit sipas kësaj Marrëveshje nuk do të gëzojë asnjë imunitet apo privilegj.

Paanshmëria

Neni 13

1. Në përmbushje të detyrave të tyre, drejtori dhe personeli tjetër i Sekretariatit as nuk do të kërkojë, as nuk do të marrë udhëzime nga ndonjë anëtar individual i Bordit ose nga ndonjë shtet ose autoritet i jashtëm për Bordin.

2. Çdo Anëtar do të respektojë karakterin ekskluzivisht ndërkombëtar të drejtorit dhe personelit tjetër dhe nuk duhet të kërkojë të ndikojë tek ta në përmbushjen e përgjegjësive të tyre.

Menaxhimi financiar

Neni 14

1. Palët do të ofrojnë kontribute vjetore financiare në buxhetin vjetor të WISE-së nga maksimumi fundi i marsit të vitit aktual.

2. Shuma, e cila duhet kontribuar nga çdo Palë, duhet të përcaktohet nga Bordi në takimin e parë të mbledhur të Bordit.

3. Shuma do të llogaritet sipas nivelit të Palës individuale të prodhimit të brendshëm bruto në barazinë e pushtetit blerës.

4. Bordi do të shqyrtojë kontributet financiare nga burimet e tjera dhe do të vendosë për miratimin e tyre. Të ardhurat e tjera mund të përfshijnë donacionet, subvencionet apo fondet e tjera nga burimet publike apo private, të tilla si: institucionet ndërkombëtare financiare, organizatat ndërkombëtare me interes të veçantë për kërkim shkencor dhe zhvillim, kontributin e anëtarit të asociuar.

5. Në rast mosplotësimi të detyrimeve financiare, nga ndonjë vend anëtar, çështja do t'i nënshtrohet Bordit për shqyrtim.

6. Bordi mund të vendosë t'i heqë të drejtën e votës Anëtarit që nuk përmbush detyrimet e tij financiare vjetore.

Buxheti vjetor

Neni 15

1. Buxheti WISE do të krijohet në nivel vjetor dhe përmbajtja e tij do të përcaktohet në Buxhetin vjetor për vitin aktual financiar. Viti financiar do të jetë funksional, nga data 1 janar deri më 31 dhjetor.

2. Buxheti vjetor do të përcaktojë të ardhurat totale dhe shpenzimet totale për një vit. Buxheti vjetor do të balancojë mbulimin e shpenzimeve totale vjetore me të ardhurat totale vjetore. WISE-ja nuk lejohet të hyjë në borxh.

3. Drejtori propozon buxhetin vjetor në Bord, jo më vonë se 90 ditë para fillimit të vitit të ri financiar.

4. Bordi do të shqyrtojë dhe miratojë buxhetin deri jo më vonë se data 31 maj e çdo viti. Buxheti mund të rishikohet nga Bordi.

Raportimi financiar dhe auditimi

Neni 16

1. Drejtori do të paraqesë raportet vjetore për ekzekutimin e buxhetit vjetor në Bord.

2. Do të kryhet një auditim vjetor nga audituesit e pavarur për përdorimin e buxhetit vjetor. Bordi duhet të miratojë raportin e auditimit. Raporti i auditimit duhet të bëhet më pas publik.

3. Audituesit do të përzgjidhen nëpërmjet një procesi përzgjedhjeje ndërkombëtarisht konkurrues.

Selia e WISE-së

Neni 17

1. WISE-ja do ta ketë selinë në Split, Republika e Kroacisë.

2. Një Marrëveshje e Vendit Pritës do të lidhet ndërmjet WISE-së dhe Qeverisë së Republikës së Kroacisë.

3. Gjuha zyrtare e punës së WISE-së do të jetë gjuha angleze.

Zotësia juridike

Neni 18

WISE-ja do të gëzojë këtë zotësi juridike kur të jetë e nevojshme për ushtrimin e funksioneve dhe përmbushjen e objektivave të tij, në veçanti, do të ketë zotësinë për të lidhur marrëveshje ndërkombëtare me shtetet dhe organizatat ndërkombëtare, të kontraktojë dhe të marrë pjesë në procedurat ligjore, duke përfshirë blerjen dhe shitjen e pasurive të luajtshme dhe paluajtshme të WISE-së.

Privilegjet dhe imunitetet

Neni 19

WISE-ja dhe kategori të caktuara të personelit do të gëzojnë privilegjet dhe imunitetet e nevojshme për përmbushjen e detyrave dhe detyrimeve që do të përcaktohen në Marrëveshjen e Vendit Pritës, e cila do të lidhet ndërmjet WISE-së dhe Qeverisë së Republikës së Kroacisë.

Kohëzgjatja

Neni 20

Kjo Marrëveshje lidhet për një periudhë të pacaktuar kohe.

Rezerva

Neni 21

Kësaj Marrëveshje nuk mund t'i bëhet asnjë rezervë.

Hyrja në fuqi

Neni 22

1. Kjo Marrëveshje i nënshtrohet ratifikimit, pranimit apo miratimit nga shtetet nënshkruese në përputhje me kërkesat e tyre ligjore përkatëse.

2. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit pas datës në të cilën i katërti i shteteve që kanë nënshkruar këtë Marrëveshje, duke përfshirë Republikën e Kroacisë, ka depo-zituar dokumentin e tij të ratifikimit, pranimit ose miratimit te Depozitari.

3. Për çdo shtet nënshkrues që ratifikon, pranon apo miraton këtë Marrëveshje pas hyrjes së saj në fuqi, në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni, kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit pas datës së depozitimit të dokumentit të saj të ratifikimit, pranimit apo miratimit te Depozitari.

Aderimi

Neni 23

1. Hapja e kësaj Marrëveshjeje për aderimin e shteteve të tjera i nënshtrohet një vendimi të veçantë të Bordit.

2. Për një shtet aderues, kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit pas datës së depozitimit të dokumentit të tij të aderimit te Depozitari.

Ndryshimet

Neni 24

1. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet me propozim me shkrim të çdo Pale.

2. Çdo propozim i tillë duhet të komunikohet nga drejtori te Palët të paktën gjashtë muaj para paraqitjes në Bord për shqyrtim dhe miratim.

3. Ndryshimet e miratuara në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni i nënshtrohen ratifikimit, pranimit dhe miratimit nga anëtarët dhe do të hyjnë në fuqi në përputhje me nenin 24 të kësaj Marrëveshjeje.

Tërheqja

Neni 25

1. Një Palë e kësaj Marrëveshjeje mund të tërhiqet nga kjo Marrëveshje me njoftim me shkrim drejtuar Depozitarit. Ky njoftim mund të hyjë në fuqi jo më parë sesa fundi i vitit financiar WISE në të cilin njoftimi është marrë nga Depozitari.

2. Një Palë e kësaj Marrëveshjeje nuk do të shkarkohet për shkak të tërheqjes së saj nga detyrimet financiare, të cilat janë krijuar gjatë kohës kur ishte Palë e kësaj Marrëveshjeje.

3. Një Palë që është tërhequr nga kjo Marrëveshje mund të aplikojë më pas për të aderuar në Marrëveshje në përputhje me nenin 25 të kësaj Marrëveshjeje.

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Neni 26

Të gjitha mosmarrëveshjet në lidhje me interpretimin apo zbatimin e kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhen nëpërmjet këshillimeve dhe bisedimeve ndërmjet Palëve.

Depozitari

Neni 27

Qeveria e Republikës së Kroacisë vepron si Depozitar i kësaj Marrëveshjeje.

Në dëshmi të kësaj, nënshkruesit, e autorizuar sipas rregullave për këtë, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

Bërë në _____, në datën _____, në një origjinal të vetëm në gjuhën angleze, i cili do të depozitohet te Depozitari. Depozitari do të transmetojë një kopje të vërtetuar të kësaj Marrëveshjeje për secilin shtet nënshkrues dhe për secilin shtet aderues.

LIGJ
Nr. 17/2016

PËR RATIFIKIMIN E PROTOKOLLIT SHTESË TË KONVENTËS SË KËSHILLIT TË EVROPËS PËR PARANDALIMIN E TERRORIZMIT

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet protokolli shtesë i Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin e Terrorizmit, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 10.3.2016

Shpallur me dekretin nr. 9473, datë 24.3.2016, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

Komiteti i Ministrave
Dokumentet CM

CM (2015) 61, përfundimtar, 19 maj 2015
Sesioni i 125-të i Komitetit të Ministrave (Bruksel, 19 maj 2015).

Protokoll Shtesë i Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin e Terrorizmit
(miratuar nga Komiteti i Ministrave, në sesionin e tij të 125-të, në datën 19 maj 2015)

Shtetet anëtare të Këshillit të Evropës dhe Palë të tjera të Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin e Terrorizmit (CETS nr. 196), nënshkrues të këtij Protokolli;

duke marrë në konsideratë se qëllimi i Këshillit të Evropës është arritja e një uniteti më të madh ndërmjet anëtarëve të tij;

me dëshirën për të forcuar më tej përpjekjet për të parandaluar dhe shtypur terrorizmin në të gjitha format e tij, si në Evropë ashtu edhe në nivel global, duke respektuar ndërkohë të drejtat e njeriut dhe shtetin e së drejtës;

duke sjellë në vëmendje të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të parashikuara, veçanërisht, në Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (ETS nr. 5) dhe protokollet e saj, si dhe Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike;

duke shprehur shqetësimin e tyre të madh në lidhje me kërcënimin e paraqitur nga personat që udhëtojnë jashtë vendit për qëllim të kryerjes, kontribuimit dhe pjesëmarrjes në vepra penale terroriste apo sigurimit apo marrjes së trajnimit për terrorizëm në territorin e shtetit tjetër;

duke pasur parasysh rezolutën 2178 (2014), të miratuar nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara në takimin e saj të 7272-të, në datën 24 shtator 2014, veçanërisht paragrafët 4 deri 6 të saj;

duke konsideruar dëshirën e saj për të plotësuar Këshillin e Konventës së Evropës për Parandalimin e Terrorizmit në aspekte të caktuara,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij Protokolli është plotësimi i dispozitave të Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin e Terrorizmit, e hapur për nënshkrim më 16 maj 2005 (më poshtë e referuar si "Konventa"), në lidhje me kriminalizimin e akteve të përshkruara në nenet 2 deri 6 të këtij Protokolli, në mënyrë që të rriten përpjekjet e Palëve për të parandaluar terrorizmin dhe efektet e tij negative për gëzimin e të drejtave të njeriut, në veçanti, të drejtës së jetesës, si për masat për t'u marrë në nivel kombëtar dhe nëpërmjet bashkëpunimit ndërkombëtar, duke pasur parasysh marrëveshjet ekzistuese të zbatueshme shumëpalëshe dhe dypalëshe ndërmjet Palëve.

Neni 2

Pjesëmarrja në shoqata apo grupe për qëllime terrorizmi

1. Për qëllimin e këtij Protokolli, "pjesëmarrja në shoqata apo grupe me qëllime terroriste" do të thotë pjesëmarrja në veprimtari të një shoqate apo grupi për qëllime të kryerjes apo kontributit për kryerjen e një apo më shumë sulmeve terroriste nga ana e shoqatës apo grupit.

2. Çdo Palë do të ndërmarrë masat që janë të nevojshme për të përcaktuar "pjesëmarrjen në një shoqatë apo grup për qëllime të terrorizmit", siç është përcaktuar në paragrafin 1, kur kryhet në mënyrë të jashtëligjshme dhe qëllimisht, si një vepër penale nën ligjin e saj të brendshëm.

Neni 3

Trajnimi për terrorizëm

1. Për qëllimin e këtij Protokolli, "marrja e një trajnimi për terrorizëm" do të thotë marrja e udhëzimeve, duke përfshirë marrjen e njohurive apo aftësive praktike nga një person tjetër në prodhimin apo përdorimin e eksplozivëve, armëve të zjarrit apo armëve të tjera, apo substancave të tjera të rrezikshme apo të dëmshme, apo në mënyra ose teknika të tjera specifike, për qëllimin e kryerjes apo kontributit për kryerjen e një sulmi terrorist.

2. Secila palë do të ndërmarrë masat që janë të nevojshme për të përcaktuar "marrjen e trajnimit për terrorizëm", siç është përcaktuar në paragrafin 1, kur kryhet në mënyrë të jashtëligjshme dhe qëllimisht, si një vepër penale nën ligjin e saj të brendshëm.

Neni 4

Udhëtimi jashtë vendit për qëllime terroriste

1. Për qëllimin e këtij Protokolli, "udhëtimi jashtë vendit për qëllime terroriste" do të thotë udhëtimi në një shtet, i cili nuk është ai i udhëtarit apo i rezidencës, për qëllime të kryerjes apo kontribuimit, apo pjesëmarrjes në një sulm terrorist, apo sigurimit ose marrjes së trajnimit për terrorizëm.

2. Secila Palë do të ndërmarrë masat që janë të nevojshme për të përcaktuar "udhëtimin jashtë vendit për qëllime terroriste", siç është përcaktuar në paragrafin 1, kur ky kryhet në mënyrë të jashtëligjshme dhe qëllimisht, si një vepër penale nën ligjin e saj të brendshëm.

3. Secila Palë do të ndërmarrë, gjithashtu, masat që janë të nevojshme për të përcaktuar si vepër penale nën dhe në përputhje me ligjin e brendshëm tentativën e kryerjes së një vepre, siç është përcaktuar në ketë nen.

Neni 5

Financimi i udhëtimit jashtë vendit për qëllime terrorizmi

1. Për qëllim të këtij Protokolli, "financimi i udhëtimit jashtë vendit për qëllime terroriste" do të thotë gjetja apo mbledhja nëpërmjet, drejtpërsëdrejti apo në mënyrë të tërthortë i fondeve të plota apo të pjesshme, duke i dhënë mundësinë një personi të udhëtojë jashtë vendit për qëllime të terrorizmit, siç është përcaktuar në nenin 4, paragrafi 1, të këtij protokolli, duke pranuar se fondet janë synuar të përdoren plotësisht apo pjesërisht për këtë qëllim.

2. Secila palë do të ndërmarrë masat që janë të nevojshme për të përcaktuar "financimin e udhëtimit jashtë vendit për qëllime terroriste", siç është përcaktuar në paragrafin 1, kur ky kryhet në mënyrë të jashtëligjshme dhe qëllimisht, si një vepër penale nën ligjin e saj të brendshëm.

Neni 6

Organizimi apo lehtësimi i udhëtimit jashtë vendit për qëllime të terrorizmit

1. Për qëllimin e këtij Protokolli, "organizimi apo lehtësimi i udhëtimit jashtë vendit për qëllime terroriste" do të thotë çdo akt i organizimit apo lehtësimit që asiston ndonjë person në udhëtimin jashtë vendit për qëllime të terrorizmit, siç është përcaktuar në nenin 4, paragrafi 1, të këtij protokolli, duke pranuar se asistenca është dhënë me synimin e terrorizmit.

2. Secila palë do të ndërmarrë masat që janë të nevojshme për të përcaktuar "organizimin apo lehtësimin e udhëtimit jashtë vendit për qëllime terroriste", siç është përcaktuar në paragrafin 1,

kur kryhen në mënyrë të jashtëligjshme dhe qëllimisht, si një vepër penale nën ligjin e saj të brendshëm.

Neni 7

Shkëmbimi i informacionit

1. Pa cenuar nenin 3, paragrafin 2, nënparagrafi "a", të Konventës dhe në përputhje me ligjin e brendshëm dhe detyrimet ndërkombëtare ekzistuese, secila Palë do të marrë masa të tilla të nevojshme, në mënyrë që të forcohet shkëmbimi në kohë i informacionit ndërmjet Palëve për çdo informacion të disponueshëm në lidhje me personat që udhëtojnë jashtë vendit për qëllime terrorizmi, siç përcaktohet në nenin 4. Për këtë qëllim, secila Palë do të caktojë një pikë kontakti në dispozicion për 24 orë, shtatë ditë në javë.

2. Një Palë mund të vendosë të caktojë një pikë kontakti tashmë ekzistuese sipas paragrafit 1.

3. Pika e kontaktit e Palës do të ketë cilësinë të komunikojë me pikën e kontaktit të një Pale tjetër në një kohë të shpejtë.

Neni 8

Kushtet dhe masat

1. Secila Palë garanton që zbatimi i këtij Protokolli, duke përfshirë krijimin, impleme-ntimin dhe aplikimin e kriminalizimit sipas neneve 2 deri 6, do të kryhet ndërsa respektohen detyrimet e të drejtave të njeriut, në veçanti e drejta e lirisë së lëvizjes, lirisë së fjalës, lirisë së shoqatës dhe lirisë së besimit, siç parashtrohet këtu, kur zbatohet tek ajo Palë, Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Drejtave Themelore, Marrëveshja Ndërkombë-tare për të Drejtat Civile dhe Politike dhe detyrimet e tjera sipas të drejtës të ndërko-mbëtare.

2. Krijimi, implementimi dhe aplikimi i kriminalizimit, sipas nenit 2 deri 6 të këtij Protokolli, duhet të jetë subjekt i parimit të proporcionalitetit në lidhje me synimet e ligjshme dhe për domosdoshmërinë e tyre në një shoqëri demokratike dhe duhet të përjashtojë çdo formë të arbitraritetit ose diskriminimit ose trajtimit racist.

Neni 9

Lidhja ndërmjet këtij Protokolli dhe Konventës

Fjalët dhe shprehjet e përdorura në këtë Protokoll interpretohen brenda kuptimit të Konventës. Ndërmjet Palëve, të gjitha dispozitat e kësaj Konvente zbatohen në përputhje me rrethanat, me përjashtim të nenit 9.

Neni 10

Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

1. Ky Protokoll është i hapur për nënshkrim nga nënshkruesit e Konventës. Protokolli është subjekt i ratifikimit, pranimit apo miratimit. Një nënshkrues mund të mos ratifikojë, pranojë apo miratojë këtë Protokoll, nëse nuk e ka ratifikuar, pranuar apo miratuar më parë Konventën apo të veprojë kështu njëkohësisht. Instrumentet e ratifikimit, pranimit apo miratimit do të depozitohen te Sekretari i Përgjithshëm i Kë-shillit të Evropës.

2. Ky Protokoll hyn në fuqi ditën e parë të muajit pas skadimit të periudhës prej tre muajsh pas depozitimit të instrumentit të gjashtë të ratifikimit, pranimit apo miratimit, duke përfshirë të paktën katër shtete anëtare të Këshillit të Evropës.

3. Në lidhje me ndonjë nënshkrues që më pas depoziton instrumentet e ratifikimit, pranimit apo miratimit, ky Protokoll hyn në fuqi ditën e parë të muajit pas skadimit të periudhës prej tre muajsh pas datës së depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit apo miratimit.

Neni 11

Pranimi në Protokoll

1. Pas hyrjes në fuqi të këtij Protokolli, çdo shtet që është pranuar në Konventë mund të pranohet, gjithashtu, te ky Protokoll apo të veprojë kështu njëkohësisht.

2. Në lidhje me çdo shtet që pranohet në Protokoll, sipas paragrafit 1 sa më lart, Protokolli hyn në fuqi ditën e parë të muajit pas skadimit të një periudhe prej tre muajsh nga data e depozitimit të instrumentit të pranimit te Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës.

Neni 12
Zbatimi territorial

1. Çdo shtet i Bashkimit Evropian, në kohën e nënshkrimit apo depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit, miratimit apo hyrjes, mund të specifikojë territorin apo territoret ku do të zbatohet ky Protokoll.
2. Çdo Palë, në një kohë më të vonshme, me deklaratë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, mund të shtrijë zbatimin e këtij Protokolli te një territor tjetër i specifikuar në deklaratë. Në lidhje me një territor të tillë Protokolli hyn, në fuqi ditën e parë të muajt pas skadimit të periudhës prej tre muajsh pas datës së marrjes së deklaratës nga Sekretari i Përgjithshëm.
3. Çdo deklaratë e bërë sipas dy paragrafëve të mësipërm, në lidhje me ndonjë territor të specifikuar në këtë deklaratë, mund të tërhiqet me njoftim drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës. Tërheqja bëhet efektive ditën e parë të muajit pas skadimit të periudhës prej tre muajsh pas datës së marrjes së këtij njoftimi nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 13
Denoncimi

1. Çdo Palë, në çdo kohë, mund të denoncojë këtë Protokoll me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës.
2. Ky denoncim bëhet efektiv ditën e parë të muajt pas skadimit të periudhës prej tre muajsh pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës.
3. Denoncimi i Konventës jep automatikisht të drejtën për denoncimin e këtij Protokolli.

Neni 14
Njoftimet

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës njofton shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, Bashkimin Evropian, shtetet joanëtare që kanë marrë pjesë në përgatitjen e këtij Protokolli, si dhe çdo shtet që ka aderuar në të ose është ftuar të aderojë në këtë Protokoll, në lidhje me:

a) çdo nënshkrim;
b) depozitim të çdo instrumenti ratifikimi, pranimi, miratimi apo aderimi;
c) çdo datë të hyrjes në fuqi të këtij Protokolli, në përputhje me nenet 10 dhe 11;
d) çdo akt tjetër, deklaratë, njoftim apo komunikim në lidhje me këtë Protokoll.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, duke qenë të autorizuar siç duhet, kanë nënshkruar këtë Protokoll.

Bërë në ....., më .....2015, në gjuhën angleze dhe frënge, ku të dyja tekste janë njëlloj autentike, në një kopje të vetme që do të depozitohet në arkivat e Këshillit të Evropës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës dërgon kopje të vërtetuara te çdo shtet anëtar i Këshillit të Evropës, Bashkimi Evropian, çdo shtet joanëtar që ka marrë pjesë në përgatitjen e këtij Protokolli dhe te çdo shtet që është ftuar të aderojë.